

Autoambulancë e re për shërbimin shëndetsor portual

Shërbimi shëndetsor portual në Durrës është pajisur ditët e fundit me një autoambulancë të re, çka pritet të përmirsojë asistencën mjekësore në rast nevojë për udhëtarët e trageteve, si dhe personalin e anijeve apo atë portual në përgjithësi.

Automjeti me vlerë 12 milion lek është vënë në dispozicion të Bërthamës shëndetsore portuale, e cila ka një personel të përhershëm prej 6 mjekësh dhe ndihmësmjekësh. Ai i shtohet financimit për mjediset e restauruara të Qendrës shëndetsore të portit detar, që janë të gatshme të përballojnë ndihmën e parë dhe rastet e emergjencave mjekësore në territorin e portit detar.

Vitet e fundit Autoriteti Portual i Durrësit është kujdesur veçanërisht për përmirsimin e kushteve të pritjes dhe përcjelljes së udhëtarëve në sheshin e trageteve, numri vjetor i të cilëve tashmë kalon 800 mijë vetë. I njëjti kujdes sipas standarteve ndërkombëtare tregohet edhe për kushtet e sigurisë në punë në sektorë të ndryshëm portualë dhe detarë.

Porti i Durrësit është një nga portat më të mëdha hyrëse të vendit tonë dhe në kalatat e tij përpunohen anije tregtare e tragete me afro 3.5 milion ton mallra në vit.



